



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 13382 prot.

Vlorë, më 11.08 2025

PROJEKT-VENDIM

NR. DATE. 2025

“PËR DHËNIE TITULLI NDERI “QYTETAR NDERI I VLORES” Z.VENI BODO”

Bazuar në Nenin 8, pika 2, Neni 9, pika 1/1.1 shkronia "d", Nenin 25, pikat 2 dhe 4, Neni 54, shkronja "ç" dhe Neni 55, pikat 2 dhe 6 të Ligiit Nr. 139/2015, date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Rregullores së Këshillit Bashkiak” të Vlorës për organizimin dhe funksionimin e tij, Propozimit të Klubit Shumësportesh “Flamurtari si edhe në Relacionin e paraqitur nga administrata e bashkisë;

VENDOSI:

- 1.T’i jepet titulli “Qytetar Nderi i Vlorës” zotit Veni Bodo, për kontributin e tij të shquar në sportin e notit, për arritjet dhe rekordet kombëtare, si dhe për përfaqësimin dinjitoz të qytetit të Vlorës në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 2.Ky titull i jepet si shprehje e mirënjohjes dhe vlerësimit të Këshillit Bashkiak të Vlorës për përkushtimin, talentin dhe arritjet e zotit Veni Bodo në fushën sportive.
3. Për zbatimin e këtij Projekt-Vendimi ngarkohet administrata dhe Kryetari i Bashkisë Vlorë.

Ky Projekt- Vendim hyn në fuqi menjëherë!

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE**

Nr. 13382 prot.

Vlorë, më 11.08 2025

RELACION

**MBI PROJEKTVENDIMIN
“PËR DHËNIE TITULLI NDERI ‘QYTETAR NDERI I VLORES’ Z. VENI
BODO”**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak të Vlorës,

Në këtë mbledhje, ju paraqesim për miratim Projektvendimin “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Vlorës” Zotit Veni Bodo”, propozim i bërë nga Klubi Shumësportësh “Flamurtari”.

Ky propozim ka për qëllim vlerësimin dhe nderimin e zotit Veni Bodo, sportist i shquar dhe rekordmen në disiplinën e notit, për kontributin e tij të vyer në zhvillimin e këtij sporti në qytetin tonë.

1. Jeta dhe karriera sportive

Zoti Veni Bodo ka lindur më 24 janar 1963 në qytetin e Vlorës. Fillimet në sportin e notit i ka që në moshë të hershme, duke ndjekur rrugën e vëllait të tij, Niko Bodo, dhe duke garuar me emra të njohur të notit vendas, si Jani Hondro, Pavllo Kisi dhe Lio Kreshpa.

Në moshën 7 vjeç, ai nisi karrierën si notar në ekipin e moshave, duke u shpallur kampion në Spartakiadë në garat 50 m, 100 m dhe 200 m stil i lirë. Rekordi i tij i parë u vendos në disiplinë të ndryshme, duke thyer rekorde kombëtare ekzistuese.

Në moshën 13 vjeç, garonte në nivele të ndryshme, duke spikatur për talentin dhe rezultatet e jashtëzakonshme. Në vitin 1979, në Sarandë, ai theu rekordin kombëtar në 400 m stil i lirë, duke vendosur kohën 4 minuta e 45 sekonda, një rekord i rëndësishëm për kohën. Në të njëjtin vit fitoi edhe garat në 100 m dhe 200 m stil i lirë, dhe u shpall notar më i mirë i kampionatit.

Gjatë 12 viteve në ekipin “Flamurtari” të Vlorës, zoti Bodo theu shumë rekorde kombëtare, fitoi trofe të shumtë dhe vendosi rekorde ekipore në stafetat 4x100 m dhe 4x200 m.

Përkushtimi dhe suksesi i tij u vlerësuan me titullin “Mjeshtër i Sportit”, duke e bërë atë një emër të nderuar në historinë e Federatës Shqiptare të Notit.

2. Vlerësimet dhe titujt

- Titulli “Mjeshtër i Sportit”
- Certifikatë Mirënjohjeje nga Federata Shqiptare e Notit
- Certifikatë Mirënjohjeje nga Shoqata Kombëtare e Veteranëve të Notit
- Titulli “Nderi i Sportit Vlorë”

3. Përkushtimi ndaj Vlorës dhe vlerat qytetare

Zoti Veni Bodo ka ruajtur gjithmonë lidhjen shpirtërore me qytetin e tij të lindjes, Vlorën. Ai ka ndjekur me interes dhe ka kontribuar në zhvillimin e sportit vendas, sidomos të notit, duke dhënë ide dhe vlerësime për rritjen e cilësisë, përzgjedhjen dhe motivimin e talenteve të reja.

Në vlerësim të kontributit të tij të vyer, Këshilli Bashkiak i Vlorës propozon që zoti Veni Bodo, “Mjeshtër i Sportit”, të nderohet me titullin “Qytetar Nderi i Vlorës”, si shprehje e mirënjohjes për punën, pasionin dhe përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm si sportist i talentuar dhe përfaqësues dinjitoz i qytetit në arenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke marrë në konsideratë të gjitha këto argumente dhe lidhjen e pandërprerë të zotit Bodo me qytetin e Vlorës, i kërkojmë Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien e titullit “Qytetar Nderi i Vlorës” zotit Veni Bodo.

DREJTOR JURIDIK

Alban Mësonjësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

Nr. 344/1 Prot.

Vlorë, më 08.08 . 2025

VENDIM

Nr. 6 . Datë 08.08.2025

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, pranë Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 08.08.2025, pasi shqyrtoi propozimin e kërkeses nr.37 Prot, datë 16.06.2025 të Klubit Shumesportesh “ Flamurtari “ :

VENDOSI

Të miratojë propozimet e paraqitura si më poshtë:

1. Vlerësim me titullin “**Qytetar Nderi**” “Z . Veni Bodo “
2. Vlerësim me titull “ **Qytetar Nderi** “ “ Z . Albert Mustafaj “

Ky Vendim ti përcillet Administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për procedurat e mëtejshme ligjore, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR

Bardhosh Gaçe



9444
16.06.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KLUBI SHUMËSPORTËSH FLAMURTARI

Nr. 37 prot

Vlorë, më 16.06.2025

KËRKESË PËR SHPALLJEN “QYTETAR NDERI” TË Z. VENI BODO
DHE Z. ALBERT MUSTAJ

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Vlorë ✓

Lënda: Propozim për shpalljen “Qytetar Nderi i Vlorës” të z. Veni Bodo dhe z. Albert Mustafaj

E nderuara Kryetare e Këshillit Bashkiak,
Të nderuar anëtarë të Këshillit,

Në emër të Klubit Shumësportësh “Flamurtari”, kemi nderin të paraqesim këtë kërkesë për shpalljen “Qytetar Nderi i Vlorës” të dy figurave të shquara të sportit shqiptar, z. Veni Bodo dhe z. Albert Mustafaj, si një akt nderimi për kontributin e tyre të jashtëzakonshëm në fushën e notit dhe përfaqësimin dinjitoz të qytetit të Vlorës në arenën kombëtare.

Z. Veni Bodo Sportist i përkushtuar dhe kontribues i rëndësishëm i notit vlonjat;

Veni Bodo u lind më 24 janar 1963, në qytetin e Vlorës. Fillimet në sportin e notit i ka të hershme kur vëllai i tij, Niko Bodo, merrte pjesë në ekipin e notit, së bashku me legjendat e kohës si Jani Hondro, Pavllo Kisi, Liro Kreshpa dhe vëllezërit Levani. Në moshën 7-vjeçare nisi rrugën si notar me ekipin e moshave, duke dalë kampion në Spartakiadë në garat 50 m, 100 m dhe 200 m stil i lirë. Rekordi i tij i parë u vendos te pionerët në katër notim, duke thyer një rekord kombëtar të mëparshëm. Në moshën 13-vjeçare garonte njëkohësisht me pionerët, të rinjtë dhe të rriturit, duke spikatur për talentin dhe rezultatet e jashtëzakonshme.

Në vitin 1979, në Sarandë, ai theu rekordin e mbajtur nga notari i njohur Skerdilajt Shyti në 400 m stil i lirë me kohën 4'45", duke hyrë në histori si notari që përmbysi një nga rekordet më të vështira të kohës. Po atë vit fitoi edhe garat 100 m dhe 200 m stil i lirë dhe u shpall notari më i mirë i kampionatit.

Në karrierën e tij prej 12 vitesh me ekipin Flamurtari i Vlorës, ai theu shumë rekorde kombëtare, mori dhjetëra trofe, dhe vendosi rekorde ekipore në stafetat 4x100 m dhe 4x200 m.

U vlerësua me titullin Mjeshtër i Sportit dhe mbetet një emër i nderuar në historinë e Federatës Shqiptare të Notit.

Z. Albert Mustafaj – Sportist me kontribut të rëndësishëm dhe aftësi të dalluara në notin vlonjat

Albert Mustafaj lindi më 25 qershor 1961 në qytetin e Sarandës, por karrierën e tij e ndërtoi e zhvilloi në mënyrë të lavdishme në qytetin e Vlorës. Fillimet e tij si notar datojnë në vitet 1970–1980 me ekipin e pionierëve, ku që në nisje



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
KLUBI SHUMËSPORTËSH FLAMURTARI

të karrierës theu rekordin e 100 metrave shpinë për pionierë. Më pas u bashkua me ekipin e të rinjve të Flamurtarit, ku fitoi garat 100 m shpinë, si dhe stafetat 4x50 m dhe 4x100 m katër notim.

Kaloi në ekipin e të rriturve nën drejtimin e trajnerit Liro Kreshpa, ku garoi krah notarëve të shquar si Skerdilajd Shyti, Agim Levani, Tomor Dano, Veni Bodo dhe Hysni Troqe.

Në fund të viteve '70 theu rekordin e 200 metrave katër notim me kohën 2'08", shumë pranë rekordit kombëtar të asaj kohe. Falë kontributit të tij, ekipi i Flamurtarit u bë rekordmen në stafetat 4x100 m dhe 4x200 m, duke thyer rekordin e ekipit kombëtar.

Mustafaj ishte notar polivalent, i cili garonte në shumë disiplina: 100 m delfin, 100 m shpinë, 200–400 m përzier, 200 m stil i lirë — ku shpesh u shpall kampion kombëtar dhe u vlerësua me medalje, certifikata mirënjohjeje dhe titullin Mjeshtër i Sportit.

Karrierën e tij si sportist e mbylli në vitin 1986, në garën e fundit kombëtare në pishinën e qytetit të Vlorës.

Duke vlerësuar maksimalisht kontributin historik të këtyre dy sportistëve të shquar, dhe trashëgiminë e tyre sportive që nderon qytetin tonë, propozojmë shpalljen e tyre me titullin “Qytetar Nderi i Vlorës”.

Dokumentacioni bashkëlidhur kësaj kërkesë përfshin:

1. Curriculum Vitae të z. Veni Bodo
2. Curriculum Vitae të z. Albert Mustafaj
3. Kopje të certifikatave, vlerësimeve dhe titujve të marra gjatë karrierës së tyre sportive

Me respekt të veçantë,
Klubi Shumësportësh “Flamurtari”

DREJTOR

Elona HASANAJ



INFORMACION
PERSONAL

Veni Bodo

📍 Lagjia “Pavarësia”

✉ venibodobg@libero.it

Gjinia Mashkull | **Datëlindja** 24.01.1963

Jeta e hershme dhe karriera

Veni Bodo u lind më 24 janar 1963, në qytetin e Vlorës. Fillimet në sportin e notit i ka të hershme kur vëllai i tij Niko Bodo mernte pjesë në ekipin e notit, në të cilin bënë pjesë edhe legjendat e notit të asaj kohe si Jani Hondro, Pavllo Kisi, Liro Kreshpa dhe vëllezërit Levani.

Në moshën 7 vjeç filloi dhe karriera e tij si notar me ekipin e moshave ku mori pjesë në kampionatin e spartakiada duke dalë kampion në garat e stilit të lirë 50m, 100m dhe 200m.

Rekordi i tij i parë fillon me pionerët në katër notim duke thyer rekordin e parë që mbahej nga sarandioti Edi Mehmeti.

Në moshën 13 vjeç aktivizohet me pionerët, të rinjtë dhe ekipin e të rriturve në tre kampionate, duke spikatur dhe premtuar shumë për të ardhmen.

Në vitin 1979 në Sarandë, Veni Bodo është notari i parë në Shqipëri që theu rekordin e mbajtur nga notari më i mirë i të gjitha kohërave vlonjati tjetër Skerdilajt Shyti. Rekord ky i pathyer për vite të të tëra. 400 m stil i lirë e realizoi nga 4'47" që ishte rekordi në fuqi në 4'45".

Thyerja e këtij rekordi ishte një sukses i madh për Veni Bodon dhe për sportin e notit.

Në këtë kampionat ai fitoj garat 100m, 200m, 400m duke u shpallur notari më i mirë i kampionatit.

Kapi normat e Mjeshtrit të Sportit. Në vazhdim në garat me të rritur ka thyer rekordin e ekipit kombëtar në 4x100, 4x200.

Veni Bodo është fitues i dhjetëra garave, fitues kupash, e ka thyer shumë rekorde kombëtare gjatë 12 viteve të karrierës së tij sportive me ekipin e Flamurtarit të Vlorës.

Ai do të largohet nga ekipi në vitin 1988.

Është nderi i Federatës Shqiptare të Notit.



Çertifikatë mirënjohje

Kjo çertifikatë i jepet

ZIZnj Venij Bode

Për pjesëmarrjen në Maratonen Kombetare te Notit "Kupa IDRIZ MUÇO"

Sarandë , Shtator 2023

Përgjegjësi I.K.S Butrintit
FUAT KARALLIU



Kryetari i SH.K.V.N
SADIK MEMA

Presidenti i F.SH.N
AGIM ÇIRAKU

[Signature]

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
FEDERATA SHQIPTARE E NOTIT

KAMPIONATI KOMBETAR

4-5 SHHTATORJE 2013

VENI 3000 (3000 NOT)

KLASIFIKUAR NË VENDIN E PARË

Në garën 50 m; stili STILI LIRE; me kohën 00'34"07

Presidenti
(AGIM ÇIRAÇU)

“Akuadrom Tirana”
pishina olimpike 50 m

Sekretar
(SUELA HAXH)

Vlorë, 25 Gusht 2019

Çertifikatë Mirënjohje

Shoqata Kombëtare e Veteranëve të Notit nderon

Z. VENI BODO

Nder i sportit - Vlorë

për kontributin e shquar dhe cilësor në forcimin dhe zhvillimin e sportit të notit
në Vlorë dhe në Shqipëri, nëpërmjet arritjeve të rezultateve të larta sportive,
duke shërbyer si model pozitiv i brezave.

Organizatorët

Për SHKYN

Sadik Memia

Kryetar



Për FSHF
Agim Ciroka

President

Për Degën Vlorë

Mirjan Kreshpa

Drejtor i degës



Vlorë, 25 Gusht 2019



Çertifikatë Mirënjohje

Shoqata Kombëtare e Veteranëve të Notit nderon

Z. VËLHY BODE

Nder i sportit - Vlorë

për kontributin e shquar dhe cilësor në forcimin dhe zhvillimin e sportit të notit në Vlorë dhe në Shqipëri, nëpërmjet arritjeve të rezultateve të larta sportive, duke shërbyer si model pozitiv i brezave.

Organizatorët

Për SHKVN

Sadik Memeti

Kryetar



President

Për Degën Vlorë

Mirjan Kreshpa

Drejtnes i degës